



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 750 prot.

Tiranë, më 8.4.2024

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME
JASHTË**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuarm, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

Specialist, Sektori Analizave, Drejtoria e Labororit Doganor, Departamenti Teknik.

Kategoria III-b, Kategoria e pagës së re IV- 1, (3 pozicione pune)

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Specialisti i Sektorit të Analizave përgjigjet tek Përgjegjësi i Sektorit të Analizave, në lidhje me analizimin e mallrave, dhe problematikat e ndryshme të hasura në sektor.
- Të ndihmojë Drejtorinë e Labororit Doganor të përmbushë misionin e saj, duke siguruar që puna të kryhet në mënyrë ligjërish korrekte dhe efikase.
- Të punojë në përputhje me S SH EN ISO/IEC 17025:2006 për një zbatim të drejtë të detyrave sipas këtij Standardi për rritje dhe përmirësim të vazhdueshëm të Sistemit të Cilësisë në Laborator.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Arsimi i Larte Master Profesional në Shkencat e Inxhinierise Kimike dhe te ngjashme me to.
- Të ketë mbi 1 vitë eksperiencë punë në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 18. 4. 2024 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Fusha e Njohurive:

1. Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
2. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.
3. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
4. Urdhëri nr. 61 datë 28.08.2023, “Rregullore e brendshme e Drejtorisë së Laboratorit”.
5. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

